REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:013864

Datë: 06.06.2022

Numri i dokumentit: 03102955

CPK.10/22
P.nr.997/21

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Gazmend Ajvazi, në çështjen përmbarimore të kreditorit I...C... J.S.C me seli në Prishtinë, rr."e Ukshin Hoti", nr.49/1, kundër debitorit I. (S.) F. me adresë në fsh.Shillovë, K.Gjilan, duke vendsour lidhur me prapësimin të datës 11.01.2022, të debitorit, jashtë seancës më 06.06.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. R E F U Z O H E T si i pabazuar prapësimi i debitorit I. (S.) F. me adresë në fsh.Shillovë, K.Gjilan, i datës 11.01.2022 i paraqitur kundër Urdhërit Përmbarimor P.nr.997/21 të datës 24.12.2021.

II. Mbetet në fuqi Urdhëri Përmbarimor i Përmbaruesit Privat Bardh Tasholli nga Ferizaji, P.nr.997/21 të datës 24.12.2021.

A r s y e t i m

Përmbaruesit Privat, Bardh Tasholli nga Ferizaji me Urdhërin Përmbarimor P.nr.997/21 të datës 24.12.2021ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori I... C.... J.S.C me seli në Prishtinë, rr."e Ukshin Hoti", nr.49/1, kundër debitorrit I.(S.) F. me adresë në fsh.Shillovë, K.Gjilan, lidhur me përmbushjen e borgjit në lartësi prej 1,858.38€ në bazë të Marveshjes mbi kredinë nr.154825, Marveshja mbi pengun nr.154825 e dt.04.12.2019 dhe vërtetimin mbi regjistrimin e pengut në zyrën e regjistrimit të pengut si dokument përmbarimor-titull ekzekutiv.

Ndaj Urdhërit Përmbarimor, debitori I. (S.) F. me adresë në fsh.Shillovë, K.Gjilan,, më dt. 11.01.2022, ka ushtruar prapësim, duke theksuar se urdhëri i përmbaruesit privat është i përcjellur me shkelje të rëndësishme të dispozitave të LPP-së, për shkak se nuk është ofruar asnjë provë së bashku me propozimin . Është e vërtetë që debitori ka blerë një telefon në një dyqan në Ferizaj por vlera e tij ka qenë 200€ mirpo nuk ka marrë asnjë udhëzim apo ndonjë kontratë se si duhet ta paguajë telefonin dhe në cilën bank. Përmbaruesi nuk ka të drejtë ta lejojë ekzekutimin ku sipas marveshjes mbi kredinë debitori ka qenë i detyruar ta lë në hipotekë pasurinë e tij të

2022:013865

luajtshme si garancion për të bërë pagesnë ë kredisë me kohë dhe dokuentacioni nuk i është dorëzuar debitorit. Gjithashtu kundështojmë edhe kamatën në lartësi prej 73.61% pasi që e njëjta është në kundërshtim me nenin 382 të LMD-së. Debitori pranon të paguajë shumën prej 200 € por jo shumën prej 1,858.38€.Nu fund i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kundërshtimi i debitorit dhe të revokohet urdhëri përmbarimor P.nr.997/21 të datës 24.12.2021.

Kreditori pas pranimit të prapsimit në afatin ligjor më datën 13.01.2022, ka ushtruar përgjegje në prapësim, duke theksuar se obligimi i debitorit me shumën si në propozim është në bazë të marveshjes mbi kredinë dhe i cili obligim është në vonesë prej 738 ditëve , prapësimi është ushtruar për shkak të zvarritjes së procedurës dhe se pretendimet e debitorit janë të pabaza . Përmbaruesi ka të drejtë të sekuestrojë pengun në bazë të neneve 166 dhe 167 të LPDS-së . Marveshja e pengut është dokument ekzekutiv në bazë të nenit 29 par.3 i LPP-së dhe i njëjti është i përshtatshëm për përmbarim andaj edhe në bazë të të cekurave ëm lart gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi prapësimi dhe të mbetet në fuqi urdhëri përmbarimor.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, e refuzon prapsimin e debitorit si të pa bazuar, për shkak se i njejti nuk përmbush asnjë nga kushtet e parapra të nenit 71 të LPP-së , sepse Marveshja mbi kredinë nr.154825, Marveshja mbi pengun nr.154825 e dt.04.12.2019 në bazë të të cilave është bazuar propozimi për përmbarim dhe pastaj nga ana e Përmbaruesit Privat është lejuar Urdhëri për Përmbarim, janë dokumente prmbarimore-titull ekzekutiv, konform nenit 22 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7.a të LPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme e në pajtim me nenin 5,22,71, 72 dhe 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin I dhe II të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
CPK.nr.10/22, Datë 06.06.2022

Gjyqtari
Gazmend Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes Gjykatës Themelore në Gjilan.